

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar, Tonka Berishaj dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional, Përparim Zeka, procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarit L.D., nga fsh. Komogllavë, Komuna e Ferizaj, për shkak të veprës penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 179 par.1 pika 1.11 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur për ankesën e mbrojtësit të akuzuarit L.D., av.I.H., e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, PKR.nr.109/17 të dt. 16.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.06.2018, morri këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit L.D., av.I.H., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj PKR.nr.109/17 i dt. 16.10.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj PKR.nr.109/17 të dt. 16.10.2017, i akuzuari L.D., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale- vrasja e rëndë në tentativë nga neni 179 par.1 pika 1.11 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe i janë përcaktuar dënimet: për veprën penale nga neni 179 par.1 pika 1.11 të KPRK dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3(tri) vite e 9(nëntë) muaj dhe për veprën penale nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dënim më burgim në kohëzgjatje prej 4(katër)muajve dhe konform nenit 80 par. 1 dhe 2 nën par. 2.2 të KPRK i ka shqiptuar dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 4(katër) viteve në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 25.01.2017 deri me datë 25.01.2017. I akuzuari obligohet që në emër të shpenzime të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50(pesëdhjetë) €, shumën prej 50(pesëdhjetë) € për kompensim të viktimave si dhe 50(pesëdhjetë) € në emër të shpenzimeve të procedurës penale, në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Të dëmtuarit L.R. dhe N.P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil, kurse i dëmtuari E.H. nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

Konform nenit 374 par.3 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme revolja e tipit EKOL-Special 99 e kalibrit 9 mm me numër serik EU16070543 me një karikator të zbrazët.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

Mbrojtësi i të akuzuarit L.D., av. I.H., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të akuzuarit L.D. ti shqiptoj një dënim më të butë.

Prokurori i Apelit me parashtrësën PPA/I nr. 204/18 të dt. 10.05.2018, ka propozuar të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit L.D., av. I.H. e ushtruar kundër aktgjykimin të Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK, Gjykata e Apelit, ka mbajtur seancën e kolegjit në të cilën ishin të pranishëm: i akuzuari L.D., ndërsa munguan Prokurori i Apelit, mbrojtja e të akuzuarit si dhe të dëmtuarit N.P., L.R., E.H. edhe pse ishin të njoftuar me rregull, andaj seanca e kolegjit u mbajt në mungesë të tyre konform nenit 390 par. 4 të KPRK. I akuzuari L.D., në seancën e kolegjit bëri disa sqarime përkitazi me pretendimet ankimore dhe mbështeti në tersi ankesën e mbrojtësit të tij.

Gjykata e Apelit, pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes dhe vlerësoi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 par.1 të KPPK, dhe pasi vlerësoi të pretendimet e theksuara në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtën e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë aspekt konform nenit 394 par.1 të KPRK-së dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje tjera të cilat detyrimisht do të kishin kushtëzuar prishjen e tij.

Po ashtu gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, pasi që nuk lejohet ankesa për këtë bazë ankimore sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës dhe me këtë është pajtuar trupi gjykues, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimit ankimor.

Mbrojtësi i të akuzuarit L.D., av. I.H. në ankesën e paraqitur kundër aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë thekson se i mbrojturi i tij në momentin kur vepra penale ka ndodhur ai ka qenë në gjendje të dehur dhe si pasojë e kësaj gjendje ka ardhur edhe deri te kryerja e veprës penale, pasi që edhe aftësia e tij për ti kontrolluar veprimet e veta pothuajse ishte zero, andaj i akuzuari

L.D., kërkonte nga gjykata që ajo të kuptonte se i njëjti këto veprime i kishte kryer pa dashje dhe pa vetëdije andaj edhe e meritonte një trajtim ligjor më të kujdesshëm dhe një dënim më të butë.

Mbrojtja po ashtu pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur drejtë për sa i përket matjes së dënimit për arsye se nuk i ka marrë për bazë rrethanat e rastit siç janë: pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, deklaratimet e tij të sinqerta se sa ishte penduar dhe veprën penale e kishte kryer nën ndikimin e alkoolit, se është baba i një fëmijë shtatë muajsh i cili ka nevojë për mbikëqyrje prindërore e mbajtje financiare. Mbrojtja pretendon edhe se dënimi i shqiptuar është në disproporcion me këto fakte ngase është shumë i lartë sepse gjykata duke mos tejkaluar autorizimet e saj ka mundur të bëjë zbutje të jashtëzakonshme të dënimit konform nenit 75 par.1 pika 1.3 të KPRK-së.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme ankimore janë të pabazuara për këto arsye:

Nga shikimi i shkresave të lëndës, konkretisht procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të dt. 09.10.2017, rezulton se i akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas gjitha pikave të aktakuzës, në praninë e mbrojtësit të tij, av. I.H., i cili është pajtuar me pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe gjykata e shkallës së parë pasi që ka gjetur se janë plotësuar të gjitha kriteret nga neni 248 par. 1 të KPPK, e ka aprovuar pranimin e fajësisë. Po qesë mbrojtësi i të akuzuarit ka vlerësuar se veprimet e të akuzuarit nuk paraqesin elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar, atëherë nuk është dashtë të mbështesë pranimin e fajësisë nga i akuzuari.

Lidhur me vendimin për dënim gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së duke vlerësuar si rrethanë lehtësuese se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, duke shprehur shkallë të sinqertë të pendimit për veprat penale, se deri më tani nuk rezulton të ketë të dhëna nga evidenca penale e të dënuarve, të jetë dënuar me aktgjykim të formës së prerë, e që këto rrethana lidhen edhe me personalitetin e të akuzuarit se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i moshës relativisht të re dhe se ngjarja kishte ndodhur aty për aty pa planifikim dhe si pasojë e një mosmarrëveshje të çastit, ndërsa në rastin konkret kjo gjykatë nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç asaj që ekziston shkalla e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmëria konkrete e veprës penale dhe duke marr parasysh propozimin e prokurorit për zbutje të dënimit, të akuzuarit konform dispozitës së nenit 75 par.1 , nën par. 1.3 të KPRK-së, i shqiptoi dënim nën minimumin e përcaktuar me ligj duke vlerësuar se bazuar në rrethanat dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale është e justifikueshme që të shqiptohet një dënim nën minimumin ligjor.

Vlerësimin e këtill të rrethanave për matjen e dënimit, si të drejtë e aprovon edhe Gjykata e Apelit , e cila vlerëson se dënimi shqiptuar ndaj të akuzuarit është në përpjesëtim me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se është në funksion të preventivës së përgjithshme, posaçërisht asaj të posaçme dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i shqiptimit të dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së. Për një dënim më të butë nuk janë

plotësuar kushtet ligjore, meqë rrethanave të cilave u referohet ankesa nuk kanë peshën e tillë që do të arsyetonin një dënim më të butë siç pretendon ankesa. Për këto arsye u deshtë që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR 216/2018 datë 19.06.2018

Procesmbajtës,

Përparim Zeka

Anëtarët e kolegjit,

Tonka Berishaj

Abdullah Ahmeti

Kryetari i kolegjit,

Xhevdet Abazi
